

**LIGJ**  
**Nr. 16/2018**  
**PËR DIASPORËN**  
*(Ndryshuar me ligjin nr. 92/2020, datë 16.7.2020; nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Objekti**  
*(Ndryshuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Ky ligj ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit e ndërveprimit ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe diasporës, me qëllim ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës.

Neni 2  
**Përkufizime**  
*(Shfuqizuar pika 1 dhe 3 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Shfuqizuar.
2. “Diaspora” përfshin:
  - a) komunitetet e hershme shqiptare në botë;
  - b) çdo person, i cili është lindur në Shqipëri dhe jeton jashtë kufijve të saj;
  - c) çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë.
3. Shfuqizuar.
4. “Vend i origjinës” është Republika e Shqipërisë.
5. “QKD” është qendër kulturore për diasporën, themeluar në vendet me interes për diasporën dhe Republikën e Shqipërisë.
6. “Këshilli Koordinues i Diasporës” (Këshilli) është organi përfaqësues dhe koordinues i marrëdhënieve me diasporën.
7. “Organizata e diasporës” është organizim vullnetar i pjesëtarëve të diasporës.

**KREU II**  
**ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MARRËDHËNIET**  
**ME DIASPORËN**  
*(Shfuqizuar fjalë në titull me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Neni 3  
**Organet përgjegjëse për diasporën**

*(Shtuar pika 6 dhe ndryshuar numërtimi për pikat 6, 7, 8 dhe 9 në “7, 8, 9 dhe 10) me ligjin nr. 92/2020, datë 16.7.2020; shfuqizuar fjalë në titull dhe pika 2, ndryshuar fjalë në pikën 4 dhe pika 10 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Organet përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën janë:

1. Këshilli i Ministrave.
2. Shfuqizuar.
3. Ministri përgjegjës për diasporën.
4. Këshilli Koordinues për Diasporën.
5. Agjencia Kombëtare e Diasporës.
6. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.
7. Qendrat kulturore për diasporën.
8. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
9. Qendra e Botimeve për Diasporën.
10. Autoritete të tjera shtetërore, ente publike, të cilat në fushën e tyre të veprimtarisë kanë çështjet e diasporës.

Neni 4

#### **Këshilli i Ministrave**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Këshilli i Ministrave:

- a) përcakton politikat e vendit të origjinës për diasporën për t'u zbatuar nga organet shtetërore, përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;
- b) përcakton mënyrën dhe politikat për regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) lidh marrëveshje sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4/1

#### **Komiteti Shtetëror për Diasporën**

*(Shtuar me ligjin nr. 92/2020, datë 16.7.2020; shfuqizuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Neni 5

#### **Ministri përgjegjës për diasporën**

*(Ndryshuar shkronja “ë” dhe ndryshuar shkronja “ë” në “f” me ligjin nr. 92/2020, datë 16.7.2020; shtuar togfjalësh në shkronjën “b” dhe ndryshuar fjalë në shkronjën “dh” dhe shfuqizuar shkronja “e” me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Ministri përgjegjës për diasporën ushtron këto kompetenca:

- a) i propozon Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve rregulluese dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme për realizimin e politikës shtetërore për marrëdhëniet me diasporën;
- b) harton nëpërmjet strukturave përgjegjëse mbikëqyr dhe koordinon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Marrëdhëniet me Diasporën;
- c) mban dhe monitoron marrëdhëniet me diasporën;
- ç) krijon dhe përditëson në mënyrë sistematike të dhëna për organizimin e saj në forume;
- d) bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse, sipas fushave të veprimtarisë, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në vendet ku jeton diaspora;
- dh) i propozon autoriteteve të përcaktuara në këtë ligj dhënien e çmimeve për kontribute të veçanta në ruajtjen e forcimit e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, si dhe për kontribute të veçanta në promovimin e Shqipërisë në botë;
- e) shfuqizuar;
- ë) propozon dhënien e bursave studentëve nga komunitetet shqiptare të diasporës për të studiuar

në universitetet e Republikës së Shqipërisë. Ato miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

f) ushtron kompetenca të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 6

#### **Qendrat kulturore për diasporën (QKD)**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. QKD-të krijohen me qëllim ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë.

2. QKD-të e ushtrojnë veprimtarinë në vendet me interes për diasporën shqiptare, lidhin marrëveshje me këto vende dhe janë në varësi të kreut të misionit diplomatik të akredituar në këto vende.

3. QKD-ja ka përgjegjësi:

a) të promovojë Shqipërinë;

b) të nxitë dhe të zhvillojë njohuri për gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë;

c) të nxitë bashkëpunimin ekonomik, inovativ, kulturor, arsimor, sportiv ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës;

ç) të mbështetë dhe të organizojë veprimtaritë kulturore, edukative e sportive, sociale dhe ekonomike;

d) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Krijimi, organizimi dhe mënyra e funksionimit të qendrave kulturore për diasporën miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të ministrit përgjegjës për kulturën.

5. QKD-të e ngritura vullnetarisht nga pjesëtarët e diasporës në shtetet pritëse njihen dhe mbështeten nga ministri përgjegjës për diasporën. Kriteret e posaçme të njohjes dhe mbështetjes rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 7

#### **Përgjegjësitë e QKD-së**

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

#### Neni 8

#### **Financimi i QKD-së**

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

### KREU III

### **MBAJTJA, FORCIMI DHE REALIZIMI I LIDHJEVE NDËRMJET VENDIT TË ORIGINËS DHE DIASPORËS**

#### Neni 9

#### **Lidhjet ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës**

*(Ndryshuar shkronja "d" me ligjin nr. 92/2020, datë 16.7.2020)*

Mbajtja, forcimi dhe realizimi i marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës e diasporës realizohen nëpërmjet:

a) përmirësimit të pozitës së pjesëtarëve të diasporës dhe mbrojtjes së të drejtave e interesave të tyre nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dy a shumëpalëshe, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare;

b) përdorimit e mësimi të gjuhës shqipe, si dhe ruajtjes së identitetit kulturor, etnik, gjuhësor;

c) promovimit të bashkëpunimit ekonomik, lehtësimit fiskal ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;

- c) sigurimit të kushteve për funksionimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;
- d) dhënies së çmimeve kombëtare dhe medaljeve për kontribut të veçantë në ruajtjen, forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, promovimin e Shqipërisë në botë dhe përkrahjen e interesave të saj. Ato miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

### **Përkrahja për mësimin dhe avancimin e gjuhës shqipe**

*(Ndryshuar pika 1 dhe 2, fjalë në pikën 5 dhe 6 dhe hequr fjalë në pikën 6 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Këshilli i Ministrave ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës shqipe, përfshirë arbërishten, si dhe variantet e tjera të hershme gjuhësore të komuniteteve në diasporë.
2. Ministri përgjegjës për diasporën së bashku me ministrin përgjegjës për arsimin ndihmojnë dhe përkrahin zhvillimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe në vendet ku ka një numër të madh pjesëtarësh të diasporës apo interes të veçantë shtetëror.
3. Ministri përgjegjës për diasporën dhe ministri përgjegjës për arsimin nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe me institucionet shtetërore homologe të vendeve ku jetojnë pjesëtarë të diasporës për organizimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe dhe njohurive të tjera kulturore për Republikën e Shqipërisë.
4. Organizimi i procesit mësimor dhe përzgjedhja e arsimtarëve në vendet përkatëse, ku jeton dhe vepron diaspora, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën dhe ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në fuqi.
5. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për arsimin, ndihmon në shpërndarjen e librave të përshtatur për mësimin dhe avancimin e gjuhës shqipe e të njohurive të tjera kulturore për Republikën e Shqipërisë në vendet ku jeton dhe vepron diaspora.
6. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për arsimin, përgatit dhe zbaton programe për mësimin e gjuhës shqipe në distancë, nëpërmjet kanaleve elektronike të komunikimit masiv, mësimin e historisë së Shqipërisë dhe njohurive të tjera kulturore për të, organizon seminare trajnuese për mësuesit, promovon dhe merr masa të ndryshme për inkurajimin e mësimin plotësues për pjesëtarët e diasporës.

Neni 11

### **Bashkëpunimi kulturor dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë**

*(Ndryshuar togfjalësh në pikat 1, 3 dhe 4 dhe pika 2 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për kulturën, përkrah aktivitetet kulturore të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.
2. Muzeu Historik Kombëtar disponon një pavijon të veçantë për diasporën.
3. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për kulturën dhe institucionet shtetërore për trashëgiminë kulturore, mbështetin komunitetet shqiptare në shtetet e ndryshme ku ata jetojnë dhe ndihmojnë, nxisin e zhvillojnë marrëdhënie ndërkulturore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve përkatëse, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore.
4. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për kulturën, ndihmon të rinjtë në promovimin, ruajtjen, kultivimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe të trashëgimisë kulturore në interes të kujtesës historike për vendin e origjinës, nëpërmjet thirrjeve publike të posaçme për bashkëpunime konkrete dhe nxjerrjen e kalendarëve të aktiviteteve të mundshme të bashkëpunimit ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës.

Neni 12

**Bashkëpunimi në fushën e sportit**

*(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për sportin, përkrah aktivitetet sportive të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit, të trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.

Neni 13

**Informimi**

*(Ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 4 togfjalësh me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Radiotelevizioni Shqiptar siguron kanal transmetimi me program radioteleviziv, dedikuar diasporës.

2. Biblioteka Kombëtare, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse për arsimin dhe kulturën, mundëson aksesin në fondin e librave *online*, pa pagesë, për edukimin dhe letërsinë, dedikuar interesave të diasporës.

3. Këshilli i Ministrave nxit dhe inkurajon aktivitetet mediatike të pjesëtarëve të diasporës së Shqipërisë, bazuar në efikasitetin e veprimtarisë së tyre.

4. Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën mundëson pasqyrimin e aktiviteteve mediatike të pjesëtarëve të diasporës.

Neni 14

**Bashkëpunimi ekonomik dhe në fushën e inovacionit**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Ministri përgjegjës për diasporën ushtron kompetencat në funksion të fuqizimit të bashkëpunimit ekonomik dhe inovacionit ndërmjet diasporës dhe ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe inovacionin sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ministri përgjegjës për diasporën në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore mbështet iniciativat e ndërmarra nga pjesëtarët e diasporës në sipërmarrje të ndryshme.

Neni 15

**Çmimi vjetor i diasporës**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Për pjesëtarët e suksesshëm të diasporës akordohen çmime.

2. Kriteret dhe mënyra e ndarjes së çmimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

**Burimet financiare**

Fondet për ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të vendit të origjinës e diasporës sigurohen nga:

a) buxheti i shtetit;

b) të ardhura nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

KREU IV

**ORGANIZIMI I DIASPORËS**

Neni 17

**Organizata e diasporës**

*(Hequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Organizata e diasporës është një organizim vullnetar, jofitimprurës i diasporës, që vepron në përputhje me rregullat e vendit të huaj ku jeton diaspora.

2. Organizata e diasporës ka si qëllim promovimin e Shqipërisë dhe përkrahjen e interesave shtetërorë të saj, ruajtjen e nxitjen e marrëdhënieve kulturore, arsimore, humanitare dhe sportive me vendin e origjinës.

#### Neni 18

##### **Këshilli Koordinues i Diasporës**

*(Ndryshuar pika 1, 3, fjalë në shkronjën ‘a’ të pikës 2, shtuar shkronjat ‘c’ dhe ‘ç’ të pikës 2 dhe pika 5 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Këshilli Koordinues i Diasporës (Këshilli) përfaqëson, bashkëpunon dhe koordinon marrëdhëniet me diasporën, përfshirë organizatat e diasporës.

2. Këshilli ka këto kompetenca:

a) identifikon problemet e diasporës, i propozon ministrit përgjegjës për diasporën masa për zgjidhjen e tyre, përcakton linja orientuese për hartimin e strategjisë për diasporën;

b) miraton rregulla procedurale për përmbushjen e veprimtarisë së tij dhe procedurën e vendimmarrjes.

c) bashkëpunon me organet përkatëse për organizimin e Samitit të Diasporës;

ç) identifikon, trajton dhe propozon çështje e projekte me natyrë ekonomike, ligjore, kulturore, sportive, edukative, shëndetësore, çështjet sociale për rininë, gruan, fëmijët e diasporës.

3. Anëtarët e Këshillit mbajnë kontakte, organizojnë aktivitete me komunitetet shqiptare në shtetet që përfaqësojnë, në varësi të agjendave të planifikuara nga Këshilli.

4. Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik.

5. Agjencia Kombëtare e Diasporës është njësia përgjegjëse për menaxhimin financiar të fondeve për organizimin e mbledhjeve të Këshillit, si sekretariat teknik.

#### Neni 19

##### **Përbërja e Këshillit**

*(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1, hequr fjalë në pikën 2 dhe shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Këshilli përbëhet nga jo më pak se 21 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të diasporës.

2. Në aktivitetet e Këshillit marrin pjesë Kryeministri, ministrat përgjegjës për diasporën, punët e jashtme, punët e brendshme, për financat dhe ekonominë, arsimin, kulturën, Akademia e Shkencave, Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë, Radiotelevizioni Shqiptar, si dhe përfaqësues të qendrave kulturore të diasporës.

3. Shfuqizuar.

#### Neni 20

##### **Kriteret për zgjedhjen në Këshill**

*(Ndryshuar pika 2 dhe shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Përfaqësuesit e diasporës, të cilët do të jenë anëtarë në Këshill, duhet të përmbushin këto cilësi:

a) të kenë integritet të lartë dhe reputacion në komunitetin ku ata jetojnë;

b) të kenë aftësi për të përmbushur detyrat për mbajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës e diasporës.

2. Përfaqësuesit e Këshillit përzgjidhen nga shtetet ku jeton komuniteti shqiptar.

3. Rregullat e hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve përcaktohen

me vendim të Këshillit të Mini-strave.

4. Shfuqizuar.

5. Vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesve i njoftohet ministrit përgjegjës për diasporën të paktën 30 ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen e Këshillit.

Neni 21

### **Mbledhja e Këshillit**

*(Ndryshuar pika 1, hequr fjalë në pikën 3 dhe shtuar 4 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Këshilli mbledhet si rregull në Ditën Kombëtare të Diasporës, në prezencën e autoriteteve të larta shtetërore.

2. Këshilli mund të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm, me kërkesën e, të paktën, 1/3 së të përfaqësuarve ose me kërkesë të ministrit përgjegjës për diasporën, me një program të përcaktuar paraprakisht.

3. Këshilli, sipas nevojës, mund të krijojë grupe pune për të trajtuar çështje teknike, me natyrë ekonomike, statutore, kulturore e sportive. Numri i anëtarëve dhe mënyra e organizmit e funksionimit të grupeve të punës përcaktohet me vendim të Këshillit Koordinues të Diasporës.

4. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij e në koordinim me Kryeministrin dhe me ministrin përgjegjës për diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Neni 22

### **Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës**

1. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjitë e caktuara prioritare për diasporën, si edhe brenda vendit, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe orientimit të prirjeve filantropike dhe investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

2. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës shërben si mekanizëm i njohur nga ligji për orientimin e prirjeve filantropike/donacioneve dhe investimeve të anëtarëve të diasporës në përpjekjet për zhvillimin social-ekonomik e kulturor në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.

3. Rregullat për veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës miratohen me ligj të veçantë.

Neni 22/1

### **Agjencia Kombëtare e Diasporës**

*(Shtuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

Agjencia Kombëtare e Diasporës krijohet si institucion varësie për të kryer funksione të përcaktuara brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore të ministrit përgjegjës për diasporën. Krijimi, misioni, funksionet dhe organizimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.

KREU V

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 23

### **Qendra e Botimeve për Diasporën**

*(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)*

1. Botimi i teksteve të veçanta, të cilat i shërbejnë diasporës, realizohet nëpërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën që financohet nga buxheti i shtetit dhe organizohet e funksionon në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23/1

**Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët**  
(shtuar shkronja “d” me ligjin nr. 92/2020, datë 16.7.2020)

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët realizon studime të specializuara për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh. Krijimi, organizimi, mënyra e funksionimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

**Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë**

Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë, krijohet një nënkomision “Për diasporën dhe migracionin”, i cili organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25

**Dita e diasporës**

**Data 18 dhjetor caktohet si Dita Kombëtare e Diasporës.**

Neni 26

(Shfuqizuar me ligjin nr. 93/2025, datë 18.12.2025)

Neni 27

**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 4; 6, pikat 5 e 6; 10, pika 4; 15, pika 2; 20, pika 3; dhe 23, pika 2, të këtij ligji.

Neni 28

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.4.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10765, datë 18.4.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**



